



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 587, datë 23.12.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT
TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 183, DATË 28.05.2020,
PËR KANDIDATEN ZNJ. ARTA DUKA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 23.12.2021, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e znj. Arta Duka nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidates për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, për shkak të tërheqjes së kandidates nga kandidimi,

VËREN

I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET

1. Me Vendimin nr. 176, datë 28.05.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile...”.

2. Me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile...”.

3. Me Vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile...”.

4. Në të trija këto procedura të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Korçë, afati i kandidimit ishte përcaktuar deri më datë 15.06.2020.

5. Brenda afatit të kandidimit për të tirja këto pozicione të lira ka kandiduar edhe znj. Arta Duka (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Aktualisht e komanduar në skemën e delegimit për një periudhë 1-vjeçare pranë Gjykatën e Apelit Korçë.

II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

6. Me Vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 173, nr. 174, nr. 176, nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182, nr. 183, nr. 184, nr. 185, nr. 186, nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:...

...4. Për kandidaten znj. Arta Duka - relator z. Alban Toro;...”.

7. Vlen të përmendet se, me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, kjo me qëllim për të ruajtur funksionalitetin e tyre, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së renditjes dhe ngritjes në detyrë të kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kritere do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

8. Bazuar në sa u parashtua në pikën 7, të këtij vendimi, Këshilli, në pikën 9, të Vendimeve nr. 176, nr. 182 dhe nr. 183 datë 28.05.2020, pra në vendimet për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Korçë, për pozicionet e lira ku ka kandiduar edhe znj. Duka, përcaktoi se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional; ...”. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, “c” dhe “ç”, të këtyre vendimeve të Këshillit, përcaktohet se: “Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t'u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen në pikën 3, të nenit 8, në pikën

4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; ... c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, që janë kriteri i “përvojës profesionale minimale”, i “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe i “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, për kandidaten znj. Arta Duka u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga institucionet kompetente.

9. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidaten znj. Arta Duka në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë si në Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli me Vendimin nr. 278, datë 08.09.2020, ka vendosur:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. Arta Duka, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 182, nr.183 dhe pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile” nr. 176, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile me Vendimet nr. 182, nr.183 dhe pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile” me Vendimin nr. 176, datë 28.05.2020.

10. Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidaten znj. Arta Duka në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës, të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli me Vendimin nr. 102, datë 18.03.2021, ka vendosur:

1. Kualifikimin e kandidatës znj. Arta Duka dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020 dhe pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 176, datë 28.05.2020.

2. Vendimi nr. 278, datë 08.09.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

11. Me kualifikimin sipas pikës 10, të këtij vendimi, znj. Arta Duka është një nga kandidatet e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në tre pozicionet e lira ku kishte kandiduar, referuar Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, ndërsa për të kishte procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, ku sipas Vendimit të Këshillit nr. 421, datë 29.09.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-

2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” si dhe sipas Vendimit të Këshillit nr. 422, datë 29.09.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”.

12. Ndërkohë, me Vendim nr.56 datë 16.02.2021 Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” vendosi:

1.Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pesë pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020 dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2.Caktimin e relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë sipas fushave të së drejtës të pozicioneve të lira të shpallura, si më poshtë:

a)Për pesë pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile - relator z. Alban Toro;

13. Më datë 25.03.2021, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, kandidatja u njoftua për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile ku ajo kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatja nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI

14. Ndërsa për kandidaten znj. Arta Duka vijonte procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 176, nr. 182 dhe nr. 183 datë 28.05.2020, kjo candidate në rrugë elektronike më datë 06.12.2021 protokolluar në Këshill me aktin nr. 5557 Prot., rikonsideroi kandidimet e saj, për të përcaktuar pozicionet për të cilat do të vijonte kandidimin, duke theksuar në kërkesën e parashtruar se tërhiqej nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 183 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor duke vijuar kandidimin për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimet nr. 176 datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

15. Në rrethanat sa sipër, bazuar në pikën 17, Seksioni B, Kreun VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), ku përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.

16. Në Mbledhjen e datës 07.12.2021 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për kandidaten znj. Arta Duka, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidatja për t'u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 183, datë 28.05.2020, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë për kandidaten znj. Arta Duka, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

IV. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATES

17. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja "a", është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të gjitha niveleve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

18. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 48 të Ligjit për Statusin, procedura administrative për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t'u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: "*Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka". Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: "*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë".**

19. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 75/2019. Kështu, në Kreun V, Seksioni B, pika 6, të tij, përcaktohet se: "*Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit".*

20. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidatja znj. Arta Duka, brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 183, datë 28.05.2020. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së ngritjes në detyrë për këtë pozicion të lirë, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim final, kandidatja u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë ngritje

në detyrë, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i saj për t'u tërhequr nga kandidimi.

V. KONKLUZIONE

21. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidatja znj. Arta Duka të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e saj për t'u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidatë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. Arta Duka, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. Arta Duka, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Kryetare NAUREDA LLAGAMI	Zëvendëskryetar MAKSIM QOKU	Anëtar KLODIAN KURUSHI	Anëtare BRIKENA UKPERAJ
---	--	---	--

Anëtar RIDVAN HADO	Anëtare FATMIRA LULI	Anëtare IRENA PLAKU	Anëtare MARÇELA SHEHU
-------------------------------------	---------------------------------------	--------------------------------------	--

Anëtar ERJON MUHARREMAJ	Anëtar ALBAN TORO	Anëtar DRITAN HALLUNAJ
--	------------------------------------	---